



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 171

Tiranë – E hënë, 16 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 78/2019, datë 5.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.....	13157
Dekret i Presidentit nr. 11383, datë 12.12.2019	Për shpallje ligji.....	13157
Ligj nr. 79/2019, datë 5.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar.....	13157
Dekret i Presidentit nr. 11384, datë 12.12.2019	Për shpallje ligji.....	13157
Ligj nr. 80/2019, datë 5.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”	13158
Dekret i Presidentit nr. 11382, datë 11.12.2019	Për shpallje ligji.....	13158
Ligj nr. 81/2019, datë 5.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.....	13158
Dekret i Presidentit nr. 11385, datë 12.12.2019	Për shpallje ligji.....	13158
Dekret i Presidentit nr. 11379, datë 10.12.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	13159

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 11.12.2019	Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore.....	13159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”	13161
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 13.12.2019	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.....	13161
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 13.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 704, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e banesave të prekura nga tërmeti i datës 21.9.2019, në qarqet Tiranë dhe Durrës”	13162
Vendim i Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile nr. 5, datë 12.12.2019	Për propozimin Këshillit të Ministrave për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri në datën 31.3.2020.....	13162
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 25.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”	13163
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 25.11.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw.....	13163
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 188, datë 25.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015.....	13166
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 25.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1”, me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total të instaluar 13917 kw.....	13167
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 25.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për licencim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror..	13169
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 192, datë 2.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	13172

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 193, datë 2.12.2019	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw dhe era me fuqi të instaluar deri në 3 mw, për vitin 2019.....	13173
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 194, datë 3.12.2019	Mbi opinionin e ERE-s, për kërkesën e OST sh.a., për dhënie në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike.....	13174



LIGJ
Nr. 78/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT NR. 4, DATË
30.11.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014
‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.

Miratuar në datën 5.12.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11383, datë
12.12.2019, të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 11383, datë 12.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 4 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 78/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 79/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË
30.11.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHTESË NË
LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, ‘PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar.

Miratuar në datën 5.12.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11384, datë
12.12.2019 të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 11384, datë 12.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 79/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 80/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË
30.11.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DHURIMIN E
APARTAMENTEVE FAMILJARËVE TË
VIKTIMAVE, SI PASOJË E TËRMETIT
TË DATËS 26.11.2019”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Miratuar në datën 5.12.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11382, datë 11.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11382, datë 11.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 80/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 81/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË
30.11.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, ‘PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar.

Miratuar në datën 5.12.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11385, datë 12.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11385, datë 12.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 81/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 7, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET**

Nr. 11379, datë 10.12.2019

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të personit të mëposhtëm:

1. Charles Stephen Gene Michael Arthur Bennett.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 807, datë 11.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË KUSHTEVE PËR KALIMIN E
PRONËS SHTETËRORE NË PRONË
PRIVATE, NË FUNKSION TË PLANEVE
TË PËRGJITHSHME VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarreve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarreve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pronari/pronarët e një prone private, si dhe çdo subjekt zhvillues, i cili ka marrë të drejtën për të zhvilluar një pronë të tillë, gëzojnë të drejtën që të kërkojnë kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, të cilat plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) sipërfaqja e pronës shtetërore është në pronësi të shtetit dhe nuk është transferuar në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësinë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar;

b) sipërfaqja e pronës shtetërore është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ato kanë dhënë pëlqimin për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas procedurave që parashikohen në këtë vendim;

c) sipërfaqja e pronës shtetërore është në kufi me pronën private që do të zhvillohet nga subjekti kërkuar;

ç) për zonën ku ndodhet sipërfaqja e pronës shtetërore që kërkohet të tjetërsohet ekziston një plan i përgjithshëm vendor për zhvillimin e territorit (sipas kuptimit të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin e territorit”), i miratuar nga organet përkatëse për planifikimin e territorit;

d) sipërfaqja e përgjithshme e pronës shtetërore, që kërkohet të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e sipërfaqes totale të pronës private që do të zhvillohet, sipas rastit, nga pronari i tyre apo subjekti zhvillues;

dh) sipërfaqja e pronës shtetërore nuk kryen më asnjë funksion publik apo ka humbur funksionet për të cilat është përdorur;

e) Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka dhënë miratimin e saj për konformitetin e projektit që kërkohet të zhvillohet me dokumentet e parashikuara, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike.

2. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në ministrinë përgjegjëse për financat, është përgjegjëse për pritjen e kërkesave, shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, si dhe i propozon ministrit përgjegjës për financat për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, duke ndjekur të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë vendim.



3. Kërkuesi paraqet kërkesën e tij pranë ministrisë përgjegjëse për financat, të shoqëruar me dokumentet, si më poshtë vijon:

a) dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që vërteton pronësinë e shtetit mbi sipërfaqen që kërkohet të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

b) dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që vërteton pronësinë e kërkuetit mbi pronën private që ndodhet në kufi apo që përfshin sipërfaqen e pronës shtetërore që kërkohet të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

c) genplanin dhe planvendosjen e sipërfaqes së kërkuar për t'u kaluar nga pronë shtetërore në pronë private, të përgatitur nga ekspertë të licencuar;

ç) dokumentacionin që vërteton se zona ku ndodhet sipërfaqja e pronës shtetërore, që kërkohet të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, përfshihet në një dokument për planifikimin e territorit për njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

4. Në rastin kur kërkuesi është subjekti zhvillues, krahas dokumentacionit të pikës 3, të këtij vendimi, duhet të paraqesë edhe kontratën e zhvillimit të lidhur me pronarët e pronës private.

5. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar prej tij.

6. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave të paraqitura bëhet duke ndjekur këto procedura:

a) për verifikimin e kërkesave të paraqitura, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në ministrinë përgjegjëse për financat, kërkon bashkëpunimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës apo organeve shtetërore që kanë lëshuar dokumentet për konfirmimin e vërtetësisë së tyre dhe këto institucione kanë detyrimin që të kthejnë përgjigje zyrtare brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës. Korrespondenca bëhet pjesë e dosjes;

b) për verifikimin e plotësisë të kushteve të përcaktuara në shkronjat “ç”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat i kërkon njërive të vetëqeverisjes vendore, nëse ekzistojnë dokumente për planifikimin e

territorit të miratuara, që prekin sipërfaqen e pronës shtetërore, objekt i kërkesës, si dhe nëse sipërfaqja e kësaj prone shtetërore kryen ose jo ndonjë funksion publik. Ndërsa për verifikimin e shkronjës “e”, të pikës 1, të këtij vendimi kërkohet konfirmim nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit;

c) verifikimi i kushteve të tjera mund të bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga një komision, i cili ka në përbërje përfaqësues nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në ministrinë përgjegjëse të financat, nga prefektura e qarkut përkatës (punonjësi i zyrës së urbanistikës) dhe nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Çdo verifikim i tillë duhet t'i raportohet ministrit përgjegjës për financat, brenda 7 (shtatë) ditësh nga verifikimi i shoqëruar me relacionin teknik;

ç) komisioni i ngritur sipas shkronjës “c”, të kësaj pike, pas verifikimit të dokumentacionit dhe të sipërfaqes së pronës shtetërore që do të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, mban procesverbal, për çdo rast, dhe nënshkruan genplanin që i përket sipërfaqes së pronës shtetërore të kërkuar.

7. Pas kryerjes së verifikimeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave miraton kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, së bashku me projektkontratën që do të lidhet për këtë qëllim.

8. Pas miratimit të vendimit nga Këshilli i Ministrave, për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, njoftohet kërkuesi që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, të nënshkruajë me strukturën përgjegjëse për tjetërsimin e pronave shtetërore në ministrinë përgjegjëse për financat, kontratën për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private.

9. Në kontratë do të përcaktohet çmimi i sipërfaqes së pronës shtetërore që do të kalohet te kërkuesi, i cili do të jetë në përputhje me çmimin e përcaktuar në hartën e vlerës së pronës përkatëse, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kontrata përcakton, gjithashtu, kushtin për momentin e kalimit të pronësisë së pronës shtetërore, që në çdo rast do të lidhet me realizimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private. Kontrata, pas nënshkrimit të saj, regjistrohet në zyrën përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shënimin përkatës.



Nëse miratimi i lejes për zhvillimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private, nuk bëhet brenda 5 (pesë) viteve nga nënshkrimi i kontratës, atëherë kontrata zgjidhet dhe palët i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që i kanë dhënë si pasojë e kësaj kontrate.

10. Çmimi i përfituar nga kalimi i sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas këtij vendimi, kalon 100 për qind në buxhetin e shtetit.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 808, datë 11.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 112, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE ‘DOKTOR’ DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË ‘PROFESOR I ASOCIUAR’ DHE ‘PROFESOR’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, e 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) kudo në tekstin e vendimit, emërtimi “Thomson Reuters”, zëvendësohet me emërtimin “Journal Citation Reports”;

b) në pikën 3, të kreut I, bëhen këto ndryshime:

i) shkronjat “a” dhe “b”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor”;

b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor i asociuar”;

ii) shkronja “c” shfuqizohet.

c) shkronja “b”, e pikës 6, të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë.”.

ç) pika 8, e kreut V, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 810, datë 13.12.2019

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 18, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënie e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri në datën 31.3.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 811, datë 13.12.2019**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 704, DATË 30.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE TË PREKURA NGA TËRMETI I DATËS 21.9.2019, NË QARQET TIRANË DHE DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 704, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për rikonstruksionin dhe rindërtimin e banesave të prekura nga tërmeti në datat 21.9.2019 dhe 26.11.2019, në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë, si edhe për përballimin e shpenzimeve të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarve”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2019, akordohen fondet si më poshtë:

a) Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor “Emergjencat civile” 10910, i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë.

b) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor “Zhvillimi i turizmit” 04760, për institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit, i Faqe | 13162

shtohet fondi prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, për akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.”.

3. Në pikën 2, fjalët “... në qarqet Tiranë dhe Durrës ...” bëhen “... në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë ...”.

4. Në pikën 3, fjalët “... për qëllimin e parashikuar në pikën 1 ...” bëhen “... për qëllimin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1 ...”.

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 5, datë 12.12.2019**

PËR PROPOZIMIN KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR ZGJATJEN E AFATIT TË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE DERI NË DATËN 31.3.2020

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile,

VENDOSI:

Propozimin Këshillit të Ministrave për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri në datën 31.3.2020, nëpërmjet marrjes së pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTORROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM
Nr. 186, datë 25.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E
“DRAFTMETODOLOGJISË SË
PËRCAKTIMIT TË TARIFËS SË SHITJES
SË GAZIT NATYROR NGA FURNIZUESI
I MUNDËSISË SË FUNDIT”

Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/6 prot., datë 22.11.2019, të Drejtorisë së Tarifave dhe të Çmimeve, mbi miratimin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”,

konstatoi se:

-Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ERE miraton metodologjinë për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

-Kjo metodologji shërben për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente në këtë fushë të rëndësishme.

-Kjo metodologji do të gjejë zbatim vetëm mbi të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit e furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e gazit natyror, të caktuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 187, datë 25.11.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2270 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 110/4 prot., datë 18.11.2019, mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 128, datë 29.8.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/39, datë 30.8.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për



procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MP-HEC” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 492/1 prot., datë 30.8.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 492/2 prot., datë 9.9.2019, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8 të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, “Për ndërtimin e HEC “Niçë”, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërisë “DEVY” sh.p.k. me “ZYFT” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit dhe autoritetit kontraktues, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikes, në zbatim të VKM-së nr. 217, datë 21.2.2008, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC “Niçë”. Kjo shoqëri, është regjistruar në QKB, në datën 26.2.2009, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, mban NUIS: K93826001D dhe mban statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara dhe zotërohet nga ortaku i vetëm “Energy Albania Group” sh.p.k.

- Kontrata e koncesionit nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data efektive e saj (data e nënshkrimit).

- Shoqëria ka bërë me dije në kërkesën e saj për licencim, se ka përfunduar punimet e veprës dhe pret të kryejë kolaudimin e saj.

- Shoqëria, me shkresën nr. 492/2 prot., datë 9.10.2019, ka përcjellë komunikimet shkresore me AKBN-në dhe MIE-n, në lidhje me konfirmimet e tyre për pjesëmarrjen në testimin e veprës dhe shtyrjen e kryerjes së testimit në një kohë të dytë, për shkak të thatësirës dhe mungesës së ujit.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 9669 rep., nr. 5663 kol., datë 12.12.2016, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kombëtar”, të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes prej 1.3024 ha e ndarë në 3.066 km shtrirje tubacioni/kanal dhe 0.19 km rrugë ndihmëse. Kjo

është pjesë e fondit pyjor/kullor publik, ekonomia pyjore në administrim të Bashkisë Maliq “Mesmal” dhe “Lozhan”, ngastrat nr. 162/a, 175/a, 176/a të ekonomisë pyjore “Mesmal”; nr. 11/a, 13/a të ekonomisë pyjore “Lozhan”, në përputhje me raportin teknik dhe të Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave.

- Afati i kësaj kontrate do të jetë deri më 12.12.2025, me të drejtë ripërtëritjeje, sipas afatit të Kontratës së Koncesionit nr. 311 rep.; nr. 45 kol., datë 2.2.2009 (neni 3 i kontratës).

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 3458 prot., datë 28.9.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kombëtar”, të lidhur midis Bashkisë Pogradec dhe shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes në cungishtë (tubacion presioni) 1.542 km, rrugë ndihmëse në funksion të ndërtimit të trasesë së vendosjes së tubacionit të presionit 0.31 km, si dhe pakësim në volum e dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 0.412 ha dhe 1.676 ha për ndërtimin e HEC “Niçë”, me kufizimet dhe koordinatat, sipas hartës pyjore ku është pasqyruar vendndodhja e HEC-it.

- Kontrata e qirasë e sipërcituar, lidhet për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga dita e nesërme e nënshkrimit të kontratës dhe palët kanë të drejtë të rinovojnë afatin e kësaj kontrate në zbatim të afatit të kontratës së koncesionit nr. 311 kol., nr. 115 rep., datë 2.2.2009.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE-së me nr. 22633/3 prot., datë 24.10.2017, me anë të së cilës kjo e fundit ka miratuar pikën e lidhjes për HEC “Niçë”, në rrjetin elektrik të shpërndarjes për kapacitetin e instaluar 2340 kw. HEC “Niçë” do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 35/6 kV, në nënstacionin elektrik Lozhan.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, “Për përdorim të rezervës ujore”, me nr. vendimi VI/5, datë 17.2.2010, lëshuar shoqërisë “DEVY” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë kryesuese të bashkimit të shoqërive, që kanë nënshkruar kontratën e koncesionit me MIE-n, për përdorim nga HEC-i, në rezervën ujore të Përroit Velçan, në sasinë 1100 l/sek. Vlefshmëria e kësaj leje përkon me afatin e kontratës së koncesionit.



- Shoqëria ka depozituar në ERE vendimin nr. 30, “Aktmiratimi për leje mjedisore”, lëshuar për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., për HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 990.72 kw.

- Nga analizimi rezulton se kapaciteti i instaluar prej 990.72 kw i pasqyruar në vendimin nr. 30, “Aktmiratimi për leje mjedisore”, lëshuar për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., për HEC “Niçë”, është i ndryshëm nga ai që ka miratuar MIE, me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, sipas projektit të zbatimit të përmirësuar.

- Shoqërisë iu kërkua që të paraqesë këtë leje në përputhje me parametrat e ndryshuar dhe të miratuar nga MIE. Në vijim të sa kërkohet nga ERE, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Ministrisë së Mjedisit për marrjen e miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të parametrave të ndryshuar të saj, me shkresë nr. 7364 prot., datë 16.7.2019, të cilën e ka përcjellë edhe në ERE.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, me nr. 492/7 prot., datë 28.10.2019, me anë të së cilës iu kërkua shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., paraqitja e lejes në përputhje me parametrat e ndryshuar dhe të miratuar nga MIE, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 492/8, datë 6.11.2019, ka deklaruar sërish se është në pritje të përgjigjes së MIE-s.

- Duke qenë se prurjet mesatare janë rritur me ndryshimin e projektit nga 1.1 m³/s në 3.5 m³/s, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k duhet të përcjellë në ERE lejen e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, “Për përdorim të rezervës ujore”, të rinovuar sipas parametrave të ndryshuar.

- Duke qenë se “Aktmiratimi për leje mjedisore”, lëshuar për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., për HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 990.72 kw, nuk përputhet me parametrat e ndryshuar nga MIE, me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., duhet të përcjellë në ERE, “Aktmiratimi për leje mjedisore”, të rinovuar sipas parametrave të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar pjesërisht;

- shoqëria koncesionare “MP-HEC” sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE kontratën shtesë të koncesionin, në vijim të miratimit nga MIE të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw, për një afat 24 vjet e 2 muaj, me kusht që:

a) shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të bëjë me dije në ERE, statusin e nënshkrimit të kontratës shtesë të koncesionin, në vijim të miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”, jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi;

b) shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE “Lejen e shfrytëzimit të ujit” të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga MIE, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE “Lejen mjedisore”, të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga MIE, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion mbi statusin e çdo dokumenti/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumente/leje.

3. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.



4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s
Eriola Sadushi**

**VENDIM
Nr. 188, datë 25.11.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE”
SHPK, NR. 262, SERIA T15, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 7,
DATË 2.2.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/1 prot., datë 21.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 728 prot., datë 11.11.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 4.8:

- germa “b” (Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie):

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. ka depozituar në ERE një vërtetim nga Credins Bank, nr. 910 prot., datë 8.11.2019, ku rezulton se



shoqëria është financuar në datën 28.7.2015, me një *overdraft*, por nuk ka paraqitur sasinë e kapitalit që vë në dispozicion për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimi të energjisë elektrike;

- germa “c” (Lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur):

- Shoqëria ka listuar kontrata të mëparshme në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, por nuk ka paraqitur një dokument provues për realizimin e tyre, sipas kushteve të kontratës;

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë, nr. 262, seria T15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 7, datë 2.2.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 189, datë 25.11.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI
HYDROPOWER” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“VELESHICA 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 5801 kw DHE “VELESHICA
2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116
kw, ME KAPACITET TOTAL
TË INSTALUAR 13917 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 111/2 prot., datë 21.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC-et “Veleshica 1” me kapacitet të instaluar 5801 kw dhe “Veleshica 2”, me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total të instaluar 13917 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 739 prot., datë 13.11.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm (Bashkimi i



përkohshëm i shoqërive BE-IS sh.p.k. dhe EL – PROM sh.p.k.), me të cilin lidhet kontrata e koncesionit.

- Kontrata e koncesionit nr. 1605 rep. dhe nr. 1037 kol., datë 18.7.2018, “Kontratë koncesionare e formës BOT (Ndërtim, Operim, Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Veleshicë”, është lidhur midis Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) “Kalisi Hydropower” sh.p.k. në cilësinë e koncesionarit dhe MIE-s në cilësinë e autoritetit kontraktues. Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- MIE, me shkresën nr. 11068/3 prot., datë 27.12.2018, drejtuar shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe për dijeni AKBN-në, ka përcjellë te këto të fundit: “Miratimin e projektit zbatimit për ndërtimin e hidrocentraleve “Veleshica 1 dhe Veleshica 2” në pellgun ujëmbledhës të lumit Veleshicë, degë e lumit Drin i Zi, qarku Dibër”. Në këtë shkresë MIE fton shoqërinë të nënshkruajë kontratën shtesë të koncesionit në të cilën do të pasqyrohen parametrat në përputhje me projektin e zbatimit.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik për shtrirjen e tubacionit dhe kanalit për HEC Veleshica 2, me nr. 32 prot., datë 3.6.2019 të lidhur midis palëve, Bashkia Kukës në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e Qiramarrësit, për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik me nr. 2077 prot., datë 28.3.2019, të lidhur midis palëve, Bashkia Dibër në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar).

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujqor” me nr. 236 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe “Leje për përdorim të burimit ujqor” me nr. 236/1 prot., datë 1.7.2019, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k..

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 9750 prot., datë 7.12.2018, me nr. 948 identifikimi dhe nr. 57 vendimi, për personin juridik “Kalisi Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtimi i HEC-ve “Veleshica 1 dhe Veleshica 2”.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., ka përcjellë në ERE Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 531, datë 18.1.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Veleshica”.

- Aplikimi i shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. - (Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). Vihet re se këto vërtetime mbajnë data hershme dhe si e tillë do t’i kërkohej shoqërisë që në zbatim të rregullores së licencimit t’i paraqesë ato me data të rifreskuara.

- (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Do t’i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije mbi ecurinë e nënshkrimit të kontratës shtesë (nëse ka pasur), pasi vihet re një ndryshim i vlerës së financimit, nga 927.928.007 lekë (sipas kontratës) është ndryshuar në 1.292.524.483 lekë (sipas projektit të zbatimit).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3.

- Neni 9, pika 3, germa “a” (Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Vërtetimi i lëshuar nga organet kompetente rezulton joaktual.

- Neni 9, pika 3, germa “b” (Bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). Do t’i kërkohej shoqërisë që për vitet 2016 dhe 2017 të paraqesë në ERE bilancet e ortakëve të saj, sipas kërkesës së rregullores.

- Neni 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Rezulton se shoqëria do të financojë projektin edhe me kredi bankare si e tillë do t’i kërkohej në vijim të dokumentojë në ERE kontratë kredie të mundshme të lidhur me bankat.

- Dokumentacioni teknik për HEC.

Neni 9, pika 4.1.1, Të dhëna specifike për HEC-in.



Neni 9, pika 4.1.2, Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” (Studimi i fizibilitetit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa “b” (Grafiku i zbatimit të Projektit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa “d” (Plani i biznesit).

- Leje nga institucione të tjera.

Neni 9, pika 4.1.5, germa “a” (Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes).

Neni 9, pika 4.1.5, germa “b” (Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike).

Neni 9, pika 4.1.5, germa “c” (Leje mjedisore).

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Veleshica 1”; me kapacitet të instaluar

5801 kw dhe Veleshica 2” me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total 13917 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 190, datë 25.11.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 4, pika 50, nenit 22, pika 2, germa “d” dhe neneve 59 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 110/7 prot., datë 22.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin procedurës për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 729 prot., datë 11.11.2019, paraqiti në ERE aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. është krijuar me VKM-në nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të



aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”, i cili ka vendosur shkëputjen e njësisë së gazit nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. dhe krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a., me kapital 100% shtetëror.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. në datën 6.1.2017, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri aksionare (sha), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) 71306034U. Kapitali fillestar i kësaj shoqërie është 359.068.000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe zotërohet nga aksionari i vetëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ERE me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar “Operatorin e Kombinuar i Gazit Natyror”, shoqërinë “Albgaz” sh.a.

- “Albgaz” sh.a. është mbajtëse e licencës së shpërndarjes së gazit natyror të miratuar nga ERE me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017.

- “Albgaz” sh.a. është mbajtëse e licencës së transmetimit të gazit natyror të miratuar nga ERE me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017.

Nga aplikimi i shoqërisë, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, rezulton se:

- Neni 9, pika 1.
- germa “a” (tipi i aplikimit) plotësuar;
- germa “b” (informacion i përgjithshëm për aplikantin) plotësuar;
- germa “c” (të dhënat mbi aplikantin) plotësuar;
- germa “d” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor), plotësuar si më poshtë:
 - pika “i” (akti i regjistrimit në QKB dhe statuti e akti i themelimit i shoqërisë tregtare) plotësuar;
 - pika “ii” (vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare për të cilët nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale). Plotësuar.
 - pika “iv” (struktura organizative/lista e personelit) plotësuar;
 - pika “v” Identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5%. Plotësuar.

- pika “vi” (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet

ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar). Pa plotësuar. Subjekti ka deklaruar se, ka nisur procesin e evidentimit të asetëve ku në fund të tij do të plotësojë dokumentacionin për këtë pikë.

- pika “vi” (lejet dhe autorizimet mjedisore) Pa plotësuar. Subjekti nuk ka përcjellë asnjë informacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- germa “e” (dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale), plotësuar si më poshtë:

- “pika “i” (deklarime prej autoriteteve për pagesat e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore) Plotësuar pjesërisht. Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar në ERE vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me nr. T01324846, datë 27.8.2019 nga i cili rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 27.8.2019.

- “ii” (bilancet financiare të audituara... për tri vitet e fundit) plotësuar.

iii. Garancinë e përshtatshme Financiare me përjashtim të furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) dhe garancinë e performancës që sigurojnë aftësinë e aplikantit për të përmbushur të gjithë detyrimet e tij nën licencën e kërkuar, duke përfshirë por pa u kufizuar; largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare prej pronarëve të aplikantit. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni është në proces përpilimi nga strukturat e brendshme të “Albgaz” sh.a.

iv) Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c) dhe rastit të tregtimit (neni 4.1.ç) një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e licencës së kërkuar. Për më tepër i licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së licencës. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se



dokumentacioni është në proces përpilimi nga strukturat e brendshme të “Albgaz” sh.a.

- “v” (vërtetimi i kryerjes së pagesës ndaj ERE-s, tarifë aplikimi) kryer pagesa pranë ERE-s në vlerën 1.000.000 lekë pranë Raiffeisen Bank, dokumentuar në ERE me vërtetimin e datës 8.11.2019.

- “vi” (Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve) Pa Plotësuar. Plani i biznesit është pjesërisht i kryer nga studime të ndryshme si “Master plani i gazit natyror për Shqipërinë dhe identifikimi i projekteve prioritare në fushën e gazit natyror” dhe “Gazifikimi i Evropës Juglindore” dhe e ka bashkëlidhur aplikimit në gjuhën angleze. Do t'i kërkohej shoqërisë ta përcjellë edhe në shqip.

Dokumente specifike për llojin e licencës,
Neni 9, pika 2, germa “d”:

Licenca për operimin e hapësirave të depozitimit të gazit natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i. Vendndodhjen gjeografike të hapësirës së depozitimit nëntokësor dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë një hartë topografike. Plotësuar.

ii. Përshkrim të kushteve gjeologjike të hapësirës depozituese nëntokësore. Plotësuar.

iii. Volumi maksimal i depozitueshëm dhe gazi i vet i nevojshëm. Plotësuar.

iv. Kërkesat minimale të cilësisë që duhet të plotësojë gazi që do të magazinohet. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni përkatës do të jetë i gatshëm në përfundim të projektit teknik të depozitës.

v. Profili i debiteve të rilëvrimit të gazit natyror. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni përkatës do të jetë i gatshëm në përfundim të projektit teknik të depozitës.

vi. Presioni maksimal i rezervuarit nëntokësor. Plotësuar.

vii. Numri i puseve dhe debitet maksimale të tyre të injektimit dhe të prodhimit. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni përkatës do të jetë i gatshëm në përfundim të projektit teknik të depozitës.

viii. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe

pajisjeve teknike që do të instalohen. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni përkatës do të jetë i gatshëm në përfundim të projektit teknik të depozitës.

ix. Kërkesat minimale të cilësisë së gazit që do të livrohët sërish dhe instalimet që sigurojnë që cilësia e përcaktuar është arritur. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni përkatës do të jetë i gatshëm në përfundim të projektit teknik të depozitës.

x. Dëshmi të kontratave/angazhimeve për depozitim. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni do të jetë i gatshëm nën fazat e para të projektit.

xi. Kategoritë dhe listën e konsumatorëve (Projekti). Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se dokumentacioni do të jetë i gatshëm në fazat e para të projektit.

xii. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/ 2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Shoqëria deklaron se, për momentin nuk është e aplikueshme, sepse nuk ka aktorë të tjerë dhe tregu i gazit nuk është konsoliduar.

xiii. Punët e Aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se do të specifikohet në studimin e fizibilitetit.

xiv. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jetëgjatësia e pritshme e projektit. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se do të specifikohet në studimin e fizibilitetit.

xv. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të hapësirave të depozitimit do të hartohen sipas nenit 56, pika 2, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Pa plotësuar. Shoqëria deklaron se do të specifikohet në studimin e fizibilitetit.

xvi. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së hapësirave të depozitimit. Pa plotësuar. Shoqëria



deklaron se do të specifikohet në studimin e fizibilitetit.

- Për mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do t'i kërkohet shoqërisë ta përcjellë në ERE në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, brenda afateve të caktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit në hapësirave të depozitimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM ANËTARE E BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 192, datë 2.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e

bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 113/1 prot., datë 25.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 prot., datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 7.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 32/47, datë 8.11.2019, dhe, në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 634/1 prot., datë 12.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 634/2 prot., datë 20.11.2019, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;



- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 193, datë 2.12.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME, NGA DIELLI ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 2 mw DHE ERA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 3 mw, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 113/3 prot., datë 26.11.2019,

të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw dhe era, me fuqi të instaluar deri në 3 mw, për vitin 2019,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw dhe era me fuqi të instaluar deri në 3 mw, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

- ERE-ja, me anë të vendimit nr. 205, datë 13.9.2018, vendosi “Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 mw dhe era me fuqi të instaluar deri 3 mw, për vitin 2018” dhe gjatë kësaj periudhe ka kryer analizat e saj në mbështetje të të dhënave dhe planeve të biznesit të shoqërive të licencuara të cilat kanë qenë subjekt i vendimmarrjes për çmimin e vitit 2017, të dhënave të marra gjatë monitorimit të kryer në zbatim të urdhrit nr. 71, dt. 24.1.2019, të kryetarit të ERE-s, si dhe të dhënat e planeve të bizneseve të të licencuarve që tashmë kanë marrë autorizimin dhe kanë lidhur kontratë me MIE-n, të cilët do të jenë subjekt i vendimmarrjes së ERE-s për vitin 2018.

- Gjithashtu është administruar dokumentacioni i paraqitur nga subjektet që kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e centraleve eolike.

- Nga shoqëria “Max Energy” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 31 prot., datë 6.11.2019, është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier.

- Nga shoqëria “Windsbab” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 18 prot., datë 12.11.2019, është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier.



- Nga shoqëria “Seman Eolik” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 2 prot., datë 12.11.2019, është kërkuar miratimi i çmimit të shitjes së energjisë nga Impianti Eolik Topojë, Fier.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish e jo çmim individual për çdo aplikues që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë VKM.

- MIE, me shkresës protokolluar në ERE me nr. 690 prot., datë 1.11.2019, shprehet se ka lëshuar miratimin për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike lundruese dhe veprave ndihmëse mbi rezervuarin e HEC Banjë, Bashkia Cërrik, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2 mw dhe duhet të vijojë me nënshkrimin e kontratës për këtë projekt, duke kërkuar nga ERE-ja parashikimin dhe përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese, duke sugjeruar që, për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese, të merret në konsideratë Metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burime të rinovueshme e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE, sipas VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli (centralet fotovoltaike) me fuqi të instaluar deri në 2 mw dhe nga era (centralet eolike) me fuqi të instaluar deri në 3 mw, për vitin 2019.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet

ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 194, datë 3.12.2019

MBI OPINIONIN E ERE-s, PËR KËRKESËN E OST SHA, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË PJESE TË INFRASTRUKTURËS SË FIBRËS OPTIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 55, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.12.2019, mbasi shqyrtoi informacionin nr. 113/2 prot., datë 26.11.2019, si dhe informacionin shtesë nr. 113/2-1 prot., datë 3.12.2019, të përgatitur nga drejtoritë e ERE-s, në lidhje me kërkesën e OST sh.a., “Mbi dhënie në përdorim nga OST sh.a. të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike palëve të treta”

konstatoi që:

- Me shkresën nr. 5005 prot., datë 24.7.2019, lidhur me përdorimin e infrastrukturës së fibrës optike, OST sh.a. parashtron kërkesën e saj për dhënie të opinionit të ERE-s për këtë qëllim.

- Bazuar në nenin 55, pika 4, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë gjithashtu edhe sistemin *wireless*, të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrës optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.



- Në frymën e Strategjisë Ndërsektoriale “Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020” miratuar me anë të VKM-së nr. 284, datë 1.4.2015, të Qeverisë, ku ndër objektivat, ndër të tjera janë dhe krijimi i kushteve të favorshme për realizimin e infrastrukturave të përshtatshme për të garantuar nivele të larta sigurie për rrjetet e informimit, si dhe për të integruar dhe informatizuar shërbimet e administratës publike dhe sektorit privat.

- Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike ka ndër asetet e tij fibrën optike (OPGW), e cila është shtrirë në një pjesë të madhe të sistemit të transmetimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fibra optike instalohet në sistemin e transmetimit për dy qëllime kryesore:

- Të realizojë mbrojtjen e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike nga shkarkesat atmosferike;

- Të realizojë transmetimin dhe komunikimin e sigurt të OST sh.a., brenda sistemit të vet të transmetimit, por dhe me OST fqinje dhe më gjerë me rrjetin evropian të transmetimit të energjisë elektrike, nëpërmjet fibrës optike OPGW të instaluar në linjat e interkoneksionit.

- OST në kuadër të kësaj korrespondence deklaron se:

- Përdorimi komercial apo dhënia në përdorim e këtyre kapaciteteve mund të realizohet totalisht e ndarë duke garantuar sipas standardeve më të mira ndërkombëtare rrjetin e transmetimit të të dhënave për nevoja të rrjetit energjetik. Për sa i përket sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit energjetik, ndarja e këtyre kapaciteteve është e mundur në mënyrë të qartë, e ndarë fizikisht, duke mos cenuar apo përbërë risk për sistemin energjetik.

- Investimet e realizuara në rrjetin e transmetimit janë kryer në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi në momentin e kryerjes së tyre, si politika 6 e ENTSO_E “Operational Handbook”, si dhe me planet e zhvillimit të OST sh.a., të miratuara nga organet drejtuese të shoqërisë dhe ERE-ja.

- OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e Organizatës Evropiane të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Evropës ENTSO-E dhe në këto rrethana, siguria e operimit të sistemit elektroenergetik shqiptar duhet të marrë në konsideratë të gjitha detyrimet që përcakton kjo e fundit, përfshirë rregulloret dhe guidat e operimit. Vërehet se marrja e mendimit paraprak nga ana e ENTSO-E nuk rezulton si detyrim me çfarë

konstatohet në guidat e operimit të kësaj të fundit. Gjithsesi, rekomandohet konsultimi apo informimi i ENTSO-E nga ana e OST përgjatë zhvillimit të këtij aktiviteti.

- Përdorimi i kapaciteteve të lira është qëllim dytësor i OST sh.a., por përdorimi i tyre do të sjellë rritjen e të ardhurave të kompanisë, si dhe reduktimin e kostove operacionale.

- Studimi i fizibilitetit tekniko-financiar lidhur me këtë aktivitet është duke u ndjekur nga Banka Botërore (WB), si dhe ky studim pritet të përfundojë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020.

ERE-ja vlerëson se studimi i fizibilitetit do të jepte një pamje më të qartë të situatës dhe gjendjes aktuale të infrastrukturës së fibrës optike, do të identifikonte qartë nevojat për ndërhyrje në këtë infrastrukturë, kostot që kërkohen për këtë investim. Ky studim do të përcaktonte edhe mundësitë dhe leverdisshmërinë e këtij projekti.

- OST-ja do të nisë fillimisht këtë aktivitet, pa asnjë kosto shtesë, por çdo fitim që do të vijë prej tij do të shërbejë për të përballuar kosto dhe investime shtesë me qëllim zgjerimin e kësaj veprimtarie.

- Në vijim të komunikimit, me shkresën nr. 5005/3 prot., datë 30.10.2019, OST sh.a. bën me dije se projekti do të jetë i ndarë në 3 faza. Në fazën e parë do të realizohen veprimtaritë të cilat nuk do të kenë kosto shtesë, ndërsa veprimtaritë në fazën e 2-të dhe të 3-të, të cilat kërkojnë kosto shtesë, do të nisin vetëm pasi të ketë përfunduar studimi i fizibilitetit, në vitin 2020. Në mënyrë specifike, OST-ja në këtë shkresë shprehet si vijon, citojmë: “Pjesa e këtij propozimi që lidhet me zhvillime të aktiviteteve shtesë përfshirë dhe infrastrukturën (ii, pika 2 dhe 3), do të nisi vetëm pasi të ketë përfunduar studimi i fizibilitetit nga WBIF, i cili nëse do të paraqesë interes, do të mbështetet dhe financohet nga EIB, në përputhje edhe me objektivat e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale ‘Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020’, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 284 datë 1.4.2015”.

- Nga analiza e draft-planit të biznesit mbi përdorimin e infrastrukturës së fibrës optike të OST sh.a. vërehet se të ardhurat nga aktiviteti do të jenë në vlerën rreth 203,460,000 lekë, kosto e investimit është në vlerën rreth 327,360,000 lekë me një normë interesi 4% dhe një afat shlyerje 6-vjeçar.



- Plani i biznesit të hartuar nuk përcakton realizimin e biznesit apo të projektit me faza si më sipër, por vlerëson se projekti ka një kosto fillestare për t'u realizuar.

- Në dokumentacionin e paraqitur nuk jepet informacion se cilat janë shërbimet të cilat do të jepen në fazën e parë të projektit, pra ato pa kosto shtesë dhe cilat janë shërbimet të cilat do të realizohen në fazat e tjera, të 2-të dhe 3-të, me kosto shtesë, si të tillë në vijim lind nevoja e dërgimit në ERE të planit të biznesit përfundimtar.

- OST ka përgjegjësinë për të mbajtur llogari financiare të veçanta nga veprimtaria e transmetimit dhe nga veprimtaria për dhënie në përdorim të infrastrukturës së fibrës optike me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit midis kategorive, si dhe moscenimit të konkurrencës, fakt i cili është tejet i rëndësishëm. Vlerësojmë se shmangia e ndërsubvencionimit me qëllim moscenimin e konkurrencës është vetëm një element, por shmangia e ndërsubvencionimi duhet të marrë në konsideratë dhe moshtimin e kostove për konsumatorët e energjisë elektrike nëpërmjet rëndimit të kostove të tarifës së shërbimit të transmetimit.

- Janë vlerësuar dokumentacioni dhe parashtrimet e bëra nga OST sh.a. për këtë çështje, depozituar në ERE me anë të korrespondencave nr. 5005 prot., datë 24.7.2019, shkresën nr. 5005/2 prot., datë 24.9.2019, nr. 5005/3 prot., datë 30.10.2019, si dhe nr. 5005/4 prot., datë 11.11.2019.

- Në përfundim të analizës së mësipërme gjykojmë se me qëllim që t'i hapet rruga zhvillimit të këtij sektori në drejtim të modernizimit në fushën e telekomunikacionit, e cila mund të sjellë edhe përfitime ekonomike për OST sh.a. në veçanti, si dhe për të tërë sektorin në tërësi, në gjykimin tonë, ERE-ja vlerëson pozitivisht idenë e OST sh.a. për përdorimin e infrastrukturës së fibrës optike për palët e treta.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të shprehë opinionin pozitiv mbi propozimin e OST sh.a. për dhënie në përdorim të infrastrukturës së fibrës optike për palët e treta duke mbajtur në konsideratë sa më poshtë vijon:

a) Moscenimin e veprimtarisë së OST sh.a. lidhur me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergetik përfshirë sigurinë kibernetike.

b) Kostot për realizimin e këtij aktiviteti të mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga kjo, duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundorë.

c) Përcjelljen në ERE e studimit të fizibilitetit, përfshirë planin e biznesit përfundimtar.

2. OST sh.a. të raportojë periodikisht çdo gjashtë muaj në lidhje me zhvillimin e këtij projekti sipas pikës 1, të këtij vendimi duke filluar nga 1.1.2020.

3. Mospërmbushja e detyrimeve të përshkruara në këtë vendim nga ana e OST-së, sjell si pasojë rishikimin nga ERE-ja të këtij vendimi.

4. ERE-ja do të rivlerësojë opinionin e saj bazuar në gjetjet dhe rezultatet e studimit të fizibilitetit që do të paraqesë OST sh.a.

5. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Autoritetin e Konkurrencës, dhe çdo palë të interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s

Erjola Sadushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë